

STATUTI
SHOQËRIA “EK TRAVEL TOURS ”
SH.P.K.

KREU I
Dispozita te per gjithshme

NENI 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuarë “shoqëria “EK TRAVEL&TOURS ”sh.p.k.


është themeluare sot më datën 16/08/2021 (dymije e njezet e një) sipas këtij Statuti të përpiluar dhe nënshkruar nga ortaket e saj :

FLODIAN DALANI, i i biri i Zurdiut, i dt.20.01.1981, me banim në Tirane,Blv ‘’Bajram Curri’’, Rr. “Irfan Tomini”, Nd. 14, shk. 5 AP 2, Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike , për të vepruar, i identifikuar nga pasaporta me nr. **ID ,I10120045T**

YLLIE ZEQAJ, e bija e Ahmetit e dt.07.11.1959, me banim në Tirane, Blv ‘’Bajram Curri’’, Rr ,’’Irfan Tomini’’ nd.28 sh 4 ap 9 , madhor, me zotësi të plotë juridike , për të vepruar, e identifikuar me nr .ID **F96107025D**

Shoqëria krijohet në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe Ligj nr.129/2014 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9901,datë14.4.2008, "Për tregtaret dhe Shoqëritë tregtare".

Statuti regullon poziten juridike të themeluesit dhe punonjësve në shoqëri, të dhënat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e shoqërisë. Shoqëria ka vulen e saj në formë Ovale me madhësi të zakonshme ku shkruhet Shoqëri private, **shoqëria “EK TRAVEL&TOURS”sh.p.k.** Shoqëria kryen veprimtarin e saj për të realizuar fitimin e saj duke u mbështetur në parimet e likujdititetit, sigurisë dhe të rentabilitetit.



NENI 2.

Objekti i veprimitarisë së shoqërisë do të jetë:

Objekti i shoqerisë, si në Shqiperi dhe jashtë do të ketë aktivitetet e mëposhtme:

✳ Sherbime ne exsport-importe

Sherbime në exsport-importe në mjete transporti ,në prodhime bujqesore industrial e biologjike e sherbime të nryshme. Objekti i veprimitarisë së shoqërise “EK TRAVEL&TOURS” shpk,konsiston në fushën eksport -importit, aktivitetit si operator turistik,organizime të udhetimeve turistike,rezervime hotelesh,shitje mallra e produkte, bileta udhetimi,sherbime turistike drejt agjensive të tjera turistike,organizim të eveneve,koferencave,trainimeve jashte shtetit etj.Ne fushen e aktivitetit si agjensi shitje biletash,transport detar,ajror dhe tokso.Transport mallrash i objektit të shoqerise, ka natyre indikuese dhe jo kufizuese.makina me qera shitje online siguracione shëndeti dhe makinash..Për realizimin e qellimit të saje shoqeria mund të bashkpunoje me cdo person fizik apo juridik në cdo mënyrë që e gjykon se është e dobishme në funksion te aktivitetit brenda koordinatave ligjore qe lejon ligji. Shoqeria “EK TRAVEL&TOURS ”shpk do të operojë dhe në fushën e Ecomerc dhe sherbime Imobilare.

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e sajë tregëtarie në përputhje të plotë me ligjislacionin shqiptare në fuqi si dhe atë tregëtar,civil,doganor tatimor fiskal dhe akte te tjera ligjore dhe nënligjore specifike për ushtrimin e sajë,sipas obiectit tëveprimitarisë se sajë.Mbi bazen e aktit te themelimit dhe statutin e sajë dhe normat e të drejtes kombëtare

✳ Shërbimet për profesionistët

Furnizimi i shërbimeve dhe pajisjeve për studime profesionale dhe teknike në lidhje me: përpunimin e të dhënavë, grafika, shërbimeve telematike, matjen e çdo lloj të sasive të medha fizike.

Dhenie me qëra e hapësirave të pajisur me mallra e mjete si dhe makineri për matje dhe analizë per studime profesionale dhe teknike në përgjithësi.

✳ Sherbime për Administratën Publike dhe Bisnesin



Organizimi dhe menaxhimi i kurseve të trajnimit.

Dhenie të këshilla teknike dhe ligjore për prokurimin e punëve publike dhe kryerjen e punimeve te ndryshme. Mbështetje për administratat publike në çështjet e sigurisë dhe higjenës së punës. Mbështetje për administraten publike në lidhje me verifikimin e projekteve, supervizimin dhe miratimit të tyre apo marrjen në dorezim pas perfundimit të punimeve. Menaxhimin e kontratave dhe kontrolli i kontratës së veçantë për sigurimin e punimeve civile dhe industriale, ne interes privat ose public.

↳ **Menaxhimi i pasurive te paluajtshme**

Kryerjen e aktiviteteve të menaxhimit të pasurive të patundshme, duke përfshirë blerjen, tjetërsimi, qiradhenien, menaxhimin financiar, të pronave të çdo lloji dhe në veçanti i komplekseve të pasurive të patundshme si dhe të rimëkëmbjes të atyre që kanë aktivitet bujqësor, urbane dhe industriale. Te kryejmë integrimi, rikonstruktimin dhe shitjen e çdo lloj të pasurive të patundshme.

↳ Inxhinierimi i proceseve industriale me furnizimin me sistemeve hardware dhe software. Organizimin dhe kontrollimin, për llogari të paleve të treta me ofrimin e shërbimeve mbështetëse të lidhura me, konsultime teknike dhe komerciale, proceset industriale, të punimeve dhe instalimeve të çdo lloji dhe vendi në sektorin industrial, transportit tokësor, detare dhe ajrore tregtisë. Ndërtimi i infrastrukturës civile, shëndetësore, port, rrugor, hekurudhor dhe aeroportit.

↳ **Furnizim me Paisje dhe makineri**

Shoqeria do të ketë përparesi në import -Eksport , të mallrave e shërbimeve, transportin kombëtar dhe ndërkontar tokso detar e ajrore , e të udhëtarve Furnizimin me pajisje dhe shërbime për kontrollin e punës, mirëmbajtjen, sigurinë në punë, optimizimin e konsumit të energjisë, kontrollin e cilësisë në aktivitetet civile, terciale dhe industriale.

Furnizimi me sistemeve kompjuterike hardware dhe software dhe metodave të monitorimit të tokës.



Shërbimet profesionale do të kryhen dhe nënshkruhen nga ekspert të licensuar dhe regjistruar ne institucionet /organet përkatëse secili brenda kompetencave të tyre përkatëse, të përcaktuara me ligj. Për kryerjen e shërbimeve ndaj të tretëve, kompania mund të përdorë eksperte që do te jene anëtarë ose jo anetare te kesaj shoqerie të njohur dhe të pranuar nga klienti, në përputhje me ligjin.

Shoqeria mund të ketë qasje në kreditë e subvencionuara të parashikuara nga ligjet europiane, aktuale kombëtare dhe rajonale.

Kompania gjithashtu mund të lidhë kontrata partneriteti dhe bashkepunimi me shoqeri te tjera, apo bashkim shoqerish ne interes te aplikimeve apo zbatimit të projekteve.

Shoqeria mund te kryej te gjitha aktivitetet industriale, komerciale, finaciare (jo me publikun e gjere), gjera te tundshme dhe te patundeshme, mund te marr pjese ne shoqeri te tjera apo bashkepunimi me objekt analog. Ajo mund të lëshojë garanci personale dhe reale edhe në favor të palëve të treta, me kusht që të gjitha këto aktivitete kanë për qëllim arritjen e qëllimit për të cilin shoqëria është ngritur.

Sherbime per Organizatat e Shoqërisë Civile

Organizimi dhe menaxhimi i kurseve te trajnimit ne lidhje me ciklin e menaxhimit të projektit, menaxhimin financiar, shkrimin e projektit sipas kerkesave të donatorit, dezinjimin e projekteve, konsulence në menaxhimin organizativ dhe rritjen e performancës profesionale.


NENI 3.

Shoqëria do të ketë Selin e saj në Tiranë, **Bulevardi “Bajram Curri”, Rr “Irfan Tomini “Nd.14, H. 5, Ap.2. Tiranë** Ajo mund të çelë filiale, degë dhe përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë dhe në vendet e tjera, në përputhje me Ligjislacionin Shqiptar.

NENI 4.

Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj me fondet e veta.

KREU II
Të drejtat dhe detyrat e Ortakut:



NENI 5.

Ortaku gëzon këto të drejta kryesore:

1. Pjesmarrjen në rezultatet e çdo formë dhe sasite të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
2. Marrjen e të gjithave të dhënavë që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarinë e shoqërisë, si dhe me të gjithë dokumentat e përunuara nga shoqëria, bilancet si dhe llogaritë ekonomike, etj.
3. Paraqitjen e propzimeve dhe shqyrimin e tyre nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakut.
4. Të heqi dorë nga shoqëria.
5. Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
6. Të marri pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaquesve të tij ose vetë.
7. Të kërkoj t'i jepen të gjitha informatat që kanë të bjënë me gjendjen prodhuse dhe tregtare të shoqërisë, si dhe të gjithë dokumentat e përpunuara të shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike, etj.
8. Të bëjë propozime dhe ti paraqesi ato për shqyrtim para organëve të shoqërisë.
9. Të emërojë dhe të shkarkojnë përfaquësit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

NENI 6.

Ortaku ka këto detyrime kryesore:

1. Të depozitojë kuotën e tyre dhe kuotat suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
2. Të marri pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vete ai.
3. T'i japi shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
4. Të kryeje detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksionëve të shoqërisë.

5. Ortaku ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria, duke i njoftuar vendimin e tij asamblesë së ortakut në rast shtimi të ortakëve 6 muaj përpara dhe duke ceduar te drejtën e zgjedhjes.
6. Heqja dorë nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra me parë ndaj shoqërisë dhe nuk pezullon detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut.
7. T'i japi shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
8. Të kryej shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.
9. Pjesëmarrja në shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë pavarsi ligjore për veprimtari të tjera dhe për të drejtat e tjera pronësie. Ai nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj tej kapitalit themelor ku ata kanë marrë pjesë.

III Kushtet Ekonomike

NENI 7.

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret Brenda 31 Marsit të vitit pasardhës, çdo vit finanziar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

NENI 8

Llogaritë vjetore inventari, raportet operacionet e veprimtarisë së vitit finanziar dhe raportet e vëçnata të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel I autorizuar miratohen nga Asamblea, Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finanziar.

NENI 9

Për të bërë të mundur zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë, vihet një kapital bazë që përbën burimin fillestare për krijimin e fondit themelor dhe të mjeteve të xhiros.

NENI 10

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakëve në vlerën **200,000.00 lekë (dyqindmijë)** dhe ndahet si më poshte:

- **Nje kuot i takon ortakut Flordian Dalani, i cili ka kontribuar në vleren 98,000.00 Leke(nentedhjetetemijë) dhe zoteron 49% te aksioneve.**

- **Nje kuot për ortakun Yllie Zeqaj,e cila ka kontribuar vleren prej 102,000.00 Lek(njeqindedymije) dhe zoteron 51% e aksioneve.** Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët e shoqërisë përkatëse

NENI 11

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave i marrin ortaku themelues. Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si edhe fondet e lëna rezervë për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamën tregtare , përfitohen prej ortakut themelues të kësaj shoqërie. Ortaku përballon humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tyre të dredhur nëpërmjet shtimit të tij ortakët kanë të dejtën e rritjes së tij. Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimenie, në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkëshorteve dhe nëpërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohet me akt notarial. Shoqëria në emër të vet është pronare ,përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, por gjithmonë në përputhje me qellimin e objektin e veprimtarisë që ajo kryen. Shoqëria mund të shesë pasuri ose të shfrytëzoj të drejta të tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci edhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare. Shoqëria krijon fonde rezevë ose dhe fonde të tjera të vecanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

NENI 12

Shoqëria është pronare e pasurive të saj dhe ka të drejtë të përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurie, në përputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarisë që kryen. Shoqëria gëzon të drejtat për mbrojtjen e pasurisë së saj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 13



E ardhura bruto e shoqërisë pasi zbritet amortizimi i të gjithë pasurisë së luajtshme e të palujtshme , sipas afateve të caktuara, kuotat që kanë të bjënë me kreditë për investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet për lëndet e para apo ndihmesë për energjinë si dhe shpenzimet e përgjithshme të saksioneve të shoqërisë dhe ato për qëllime të tjera prodhuese e joprodhuese , i takojnë orakeve të shoqërisë.

KREU IV
Administrimi
NENI 14.

Organ vendimor I shoqerise eshte Asamblea e Ortakut.

Mbledhja e Asamblee mund të thirret nga administratori , nga eksperti kontabel I autorizuar.

Asambleja vendos:

1. Për çeshtje të tillë si emërim ose shkarimin e personelit Inginierotekik sipas strukturave të ngritura nga shoqëria, eksperitn kontabël të autorizuar dhe likudiesit, miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollit.
2. Miratimin e programit vjetor të veprimtarise së shoqërisë,
3. Për fitimin dhe rezultatet.
4. Për çeshtje të tillë si ndryshimin e statutit , zvoglimin e pjesëve të kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjesevë të kapitalit themeltar, shëndërrimin e shoqërisë me përgjegjsi të kufizuar në forma të tjera , mbylljen e shoqërisë para kohe. Asamblea thirret së paku një herë në vit, duke lajmeruar me shkrim 30 ditë përpara.

NENI 15

Kompetencat ekzekutive të Asamblesë së Ortakut të shoqërisë janë:


1. Përcaktimi i të drejtave kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Ndryshimet në emërtesen e prodhimit që do të realizohet dhe të punimëve që do të kryhen, që janë pjesë përbërse e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.



3. Propozimet e nevojshme për ndryshimet në kapitalin bazë të shoqërisë.
4. Përcaktimi i regjimit dhe I kushteve të zbatimit të parimeve të llogarisë ekonomike.
5. Përcaktimi i rregullave dhe I normave , që përkufizojnë raportet me gjirin e shoqërisë , duke përfshirë dhe kuadrin e personelit.
6. Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë.
7. Përcaktimi i organikës dhe ndarja e vendeve drejtuese ndërmjet përfaqësive të ortakëve.
8. Emërtimi dhe zevendësimi i Administratorit të përgjithshëm të shoqërisë.
9. Krijimi i organeve të tjera të domosdoshëm për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- 10.Përcaktimi i madheseisë së kuotave për formimin e kapitalit bazë të shoqërisë.
- 11.Paraqitura e propozimeve për rregullimin, krijimin dhe përfitimin nga fondet e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe përcaktimi I rregullave për shlyerjen e borxhëve.
- 12.Marrja e vendimit për krijimin e filialeve të degëve e të përfaqësive si dhe përcaktimin e veprimtarisë së tyre.
- 13.Përcaktimi I rregulloreve për procedurën e punës të administratës.
- 14.Përgatitja e propozimit për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë.
- 15.Përzgjedhja e anëtarëve për komisionin e likujdimit të cilët emërohen dhe rievokohen nga Asamblea e Ortakut.
- 16.Kryerjen e veprimtarive për likujdimin e llogarive, që I përkasin ortakut dorëheqes të shoqërisë.
- 17.Marrjen e vendimit për kërkimin dhe përdorimin e kredive afatgjata.

NENI 16

Veprimtaria operative e shoqërisë “EK TRAVEL&TOURS ”sh.p.k drejtohet nga Administratori. Administrator i shoqërisë emërohet znj. **Yllie Zeqaj** e cila në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në gjithë veprimtarinë e saj. Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej pesë vjetesh financiare, me përjashtim të rastëve të dorëheqjes ose shkarkimit të parakohshem. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet aktëve që janë në



përputhje me objektin e veprimitarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk I njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligeve, për shkelje të statutit apo për faj të tij gjatë administimit të shoqërisë.

Kopetencat e administratorit në shoqëri janë:

1. Të miratoj planet e llogarive ekonomike pas përfundimit të tyre në kuadrin e veprimitarisë së shoqërisë.
2. Të bëjë propozimet e nevojshme në mbledhjen e asambles kur lind nevoja e kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Të miratoj akte normative që përcaktojne raportet në gjirin e shoqërisë duke perfshire kuadrin dhe personelin.
4. Të përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë.
5. Të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
6. Të propozojë në mbledhjen e asamblesë për krijimin e njësive , strukturave si filiale , degë e përfaqësi në qytetet e tjra të vendit apo dhe jasht shtetit.
7. Të përgatisi propozimet për pushimin e veprimitarisë së shoqërisë dhe tija paraqesin ato Asamblesë për miratim.
8. Të përzgjedhi ekspertet kontabel dhe anëtarët e komisionit të likuidimit dhe të paraqesin propozimet për miratim në asamble.
9. Të sigurojë zbatimin e përpiktë të vendimeve të asamblesë.
- 10.Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërise dhë pagat e tyre.
- 11.Organizon punën për realizimin e planëve të shoqërisë dhe raporton për to në përputhje me programet e planet e përgjithshme , administron pasurinë e shoqërisë , duke përfshirë këtu mjetet financiare , brenda caqeve të vendimeve të marra nga organi administrative I shoqerisë. Drejton e kontrollon veprimitarinë e filialeve të degëve e të përfaqësive. Përfaqëson shoqërinë përpara të tretëve si gjykatë, etj. Nënshkruan kontrata në emër e për llogari të shoqërisë dhe siguron vënien e tyre në jetë.
- 12.Merr të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me ato veprimtari të shoqereisë, që nuk janë në kompetencë ekzekutive të Asamblesë së Ortakut.
- 13.Të nënshkruaj marrëveshjet me shoqëri të tjera Shqiptarë apo të huaja për marrje pjese në tendera apo në koncensione.

- 14.Raporton dhe i përgjigjet Asamblesë për zbatimin e veprimtarive të shoqërisë si dhe për realizimin e objektivave dhe detyrave që janë në kompetencë të tij. Siguron drejtimin e shoqërisë.
- 15.Përfaqëson shoqërinë në lidhje me të tretët brenda caqeve të objektit të veprimtarisë së saj, përveç çështjeve që kërkojnë unanimitetin e ortakëve ose që kanë të bëjnë me kompetencat që ky statut i atribuon Asamblesë së Ortakut. Organizon zbatimin e saktë të vendimeve të Asamblesë së Ortakut.
- 16.Bën hapjen e letër kredive në lekë e në valute të huaj.

NENI 17

Marrëdhëniet e punës në shoqëri.

Marrëdhëniet e punës në shoqëri e filiale , në degë e përfaqësuesit rregullohen në përputhje me vendimin pér krijimin e shoqërisë, legjislacionit shqiptar dhe me këtë statut si dhe nëpërmjet kontratës së punës pér çeshtjet që nuk rregullohen në konratën e punës , zbatohen dispozitat e legjislacionit të punës. Punësimi i punënjësve në shoqëri bëhet mbi bazën e kontratës kolektive dhe individuale të punës. Në konratën e punës rregullohen këto çështje: Kushtet dhe mënyra e marrëdhënieve së punës. Fillimi I punës së punonjësve dhe caktimi i tij në vendin e punës. Koha e punës dhe caktimi I kohës së punës, puna e natës,puna jashtë kohës normale , puna në ditët e pushimit favor , festive zyrtare.Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës. Pushimet dhe mungesat, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punonjësve pér zbatimin e detyrave të punës. Pushimi I marrëdhënieve së punës. Paga e punës së punonjësit ,shpërbllimi i punës dhe shpërbllimet dhe të tjera.Shoqëria merr përsipër të bëjë sigurimin e të punësuarëve pranë saj në organet përkatëse duke derdhur rregullisht kontributet në përqindjet caktuara sipas dispozitave ligjore në fuqi. Për të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent pér shqyrtimin e tyre është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë.

KREU V

Mbyllja e Shoqërisë:

NENI 18



Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin të ortakut, kur gjatë 5 vjetëve nuk rezulton rentablë ose kur ortaku heq dorë nga shoqëria si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijuar të shoqërisë. Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likujdimi. Afati i veprimtarisë së shoqërisë caktohet e pakufizuar duke filluar nga 25.08.2021, si vit I parë I veprimtarisë.

NENI 19

Kur shoqëria likujdohet:

Asambleja e ortakut emëron likuditorin, të cilit I paraqitet bilanci dhe shoqëria I jep fund veprimtarisë së saj ne çastin e miratimit të këtij raporti të hartuar. Pasuritë që janë venë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Të ardhurat cedohen ndërmjet ortakeve në përpjestim me kuotën e venë. Mjetet financiare të fituara si rezultat I veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondet financiare ndahen ndërmjet ortakeve në përpjestim me kuotat e vëna, pasi të jenë bërë pagesat për kreditoret.

NENI 20

Ky statut është i përpiluar 5 (pesë) kopje dhe hynë në fuqi menjeherë.

Hartuar me 16/08/2021

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“SHOQËRIA “EK TRAVEL & TOURS ” SH.P.K.

1 - FLODIAN TEME DALANI



2- YLLIE AHMET ZEQAJ

